# UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË
# FAKULTETI EKONOMIK

| Programi mësimor i lëndës (Syllabusi) | | |
|---|---|---|
| **Fakulteti:** | Fakulteti Ekonomik | |
| **Programi/Departamenti:** | Biznes dhe Menaxhment | |
| **Specializimi:** | Menaxhment dhe Ndërmarrësi | |
| **Niveli:** | Bachelor | |
| **Kodi i lëndës:** | | |
| **Lënda:** | Menaxhment strategjik | |
| **Statusi i lëndës:** | | Obligative |
| **Semestri:** | | Verorë |
| **Fondi i orëve:** | 2+1 | |
| **ECTS:** | 6 | |
| **Orari/Salla** | Salla 402 / Amfiteatër 2 | |
| **Viti akademik:** | Viti i III-ë, semesri VI. | |
| **Mësimdhënës/e:** | Prof. Dr. Isa TAHIRI | |
| **Asistent/e:** | | |
| **Kontaktet:** | Mësimdhënës/e | Asistent/e |
| E-mail: | Isa.tahiri@umib.net | |
| Telefon: | +383 44 148 499 | |

| | |
|---|---|
| **PERMBAJTJE** | Menaxhimi Strategjik është një modul i integruar që synon të ofrojë një vështrim gjithëpërfshirës të organizatave. Megjithëse do të mbështetet në shumë nga modulet e biznesit të cilave janë trajtuar gjatë studimeve, ai shkon përtej lidhjes së thjesht të moduleve të ndryshme funksionale që keni pasur. Duke përdorur bazat në fusha të ndryshme si kontabiliteti, marketingu, financa dhe menaxhimi, operacionet dhe sistemet e informacionit të menaxhimit, do të eksplorohen disa teori dhe praktika bashkëkohore të organizatave. Do të trajtohen shumë tema të dukshme si skanimi mjedisor, reagimi i korporatës ndaj ndryshimit dhe qëndrueshmërisë mjedisore, sjellja strategjike dhe etike, analiza e industrisë dhe globalizimi i bizneseve. Moduli është i strukturuar për të nxitur aftësi analitike, njohuri, reflektuese dhe verbale, dhe për t'ju ekspozuar ndaj ndërlikimeve të vendimmarrjes organizative brenda kontekstit global dhe brenda një epoke të qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë së korporatës. Do të ketë një theks në teoritë që qëndrojnë pas natyrës dhe funksionit të organizatave në tërësi. |
| **QËLLIMI** | Qëllimi i lëndës së menaxhmentit strategjik është që t'i pajisë studentët me njohuri të vancuara mbi konceptet kryesore të strategjisë, gjithashtu përmes këtij moduli synohet që njohurit e fituara studentët t'i integrojnë dhe të zbatojnë në paraprak në situata të ndryshme të menaxhimit të korporatave, biznesve, etj. |

| ARRITSHMËRIA | ❑ **Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:**<br><br>● **<u>Të përshkruajnë</u>** rëndësinë e planifikimit të menaxhimit strategjik në një mjedis dinamik biznesor,<br>● **<u>Të kuptojnë</u>** procesin e menaxhimit stratexhik dhe formulimin e stratexhisë, të dijë të pë përcaktoj vizionin, misionin, objektivat kryesore, objektivat specifike të bizneseve, të përcaktojnë shkallen e rrezikut të mos realzimit të strategjive,<br>● **<u>Të zbatojnë</u>** monitorimin dhe kontrolloin e strategjisë së biznesit duke u bazuara në strategjin e planifikuar,<br>● **<u>Të argumentojnë</u>** aplikimin e metodave të nevojshme për analizat strategjike, duke përdorur analizën SWOT, skenaret, planifikimin e bazuar në supozimet, për të përcaktuar realizimin e aktiviteteve të planifikuara me ato të realizuara,<br>● **<u>Të rekomandojnë</u>** qasje të qëndrueshme të menaxhimit strategjik duke realizuar analiza të nevojshme me qëllim të shfrytezimit të resurseve në mënyrë racionale dhe efikase, dhe<br>● **<u>Të krijojnë</u>** analiza adekuate strategjike konform analizave të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm me të cilën ballafaqohen bizneset, duke përdorur resuresit dhe përfitimet përkatëse. | |
|---|---|---|
| **PROGRAMI** | **Javët** | **Tema** |
| | Java - I | Njoftimi me planprogramin mësimor të lëndës dhe obligimet e dyanshme profesor – student |
| | Java – II | Nje kendveshtrim i pergjithshem i menaxhimit strategjik |
| | Java - III | Natyra e menaxhimit strategjik |
| | Java - IV | Formulimi i strategjise |
| | Java – V | Vizioni dhe misioni i biznesit |
| | Java - VI | Analiza e jashtme dhe analiza e brendshme |
| | Java - VII | Testi I-rë |
| | Java - VIII | Strategjite ne veprim |
| | Java - IX | Analiza dhe zgjedhja e strategjise |
| | Java - X | Implentimi i strategjise |
| | Java - XI | Çeshtjet e marketingut, financave, kontabilitetit, hulumtimit dhe zhvillimit |
| | Java - XII | Vleresimi i strategjise |
| | Java - XIII | Rishikimi ,vleresimi dhe kontrolli i strategjise |
| | Java - XIV | Projektet, prezantimet, etj |
| | *<u>Java - XV</u>* | Testi II-të |

**LITERATURA**

**Literatura themelore:**

1. Izet Zeqiri: Menaxhmenti Strategjik, Shkup, 2017
2. Vasilika Kume “Manaxhimi Strategjik” 2007

**Literatura plotësuese**:

1. Fred David – “Strategic Menagment” 2010
2. Menaxhimi Strategjik, Grup Autoresh Zagreb, Kolegji Victory, 2008

**METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS**

Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratës, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, vetëvlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohen në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audiovizuele përmes teknologjisë elektronike.

Prezantimi i temës mësimore në Power Point, ushtrime në fleta të mëdha Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza, hulumtime dhe ushtrime ekipore. Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar, etj. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore.

Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike te ndërmarrjet prodhuese private e publike dhe te organizatat fitim prurëse. Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është dhënë në pjesën tabelare të programit të studimit. Raporti teori praktike : 65% teori dhe 35% praktikë/seminare/ushtrime.

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)**

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime | 1 | 15 | 15 |
| Konsultime me mësimdhënësin/asistenten | / | / | / |
| Kolokiume /seminare | 2 | 15 | 30 |
| Detyra të pavarura | 2 | 3 | 6 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 5 | 5 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 3 | 6 | 18 |
| Projektet, prezantimet, etj | 4 | 4 | 16 |
| **Totali** | | | **150 orë** |

| | |
|---|---|
| **VLERËSIMI** | **Metodat e vlerësimit**<br>Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të fituara të studentit do të bëhet përmes pjesëmarrjaës dhe interaktiviteti në ligjërata dhe ushtrime me 10 %, Punime dhe projekte grupore hulumtuese me 10 %, Testi i parë vlerësimi me 40 % dhe Testi i dytë vlerësimi 40 %. Total i pikëve 100 %.<br>**Shkallët e notave :**<br>50-me pak – nota 5 (pesë)<br>51-60 % - nota 6 (gjashtë)<br>61-70 % - nota 7 (shtatë)<br>71-80 % - nota 8 (tetë)<br>81-90 % - nota (nëntë)<br>91-100 % - nota (dhjetë) |
| **POLITIKAT AKADEMIKE** | Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera te universitetit. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit. |

**Mitrovicë**

30/12/2021

**Bartës/e i/e lëndës:**

**Prof. Dr. Isa TAHIRI**

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)